

VENDIM
Nr.113, datë 22.2.2006

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES TË PËRDORË PROCEDURË TË VEÇANTË
PROKURIMI, ME KORPORATËN AMERIKANE “LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC
(LMGI)”, PËR NDËRTMIN E SISTEMIT TË VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS DETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të “Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Korporatës Amerikane “Lockheed Martin Global Inc (LMGI)”, për ndërtimin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare”, miratuar me ligjin nr.9384, datë 4.5.2005, dhe të nenit 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurë të veçantë prokurimi, me korporatën amerikane “Lockheed Martin Global Inc (LMGI)”, për ndërtimin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) të Republikës së Shqipërisë, si një vepër e veçantë e mbrojtjes dhe e sigurisë kombëtare.

2. Negociatorët e caktuar nga Ministri i Mbrojtjes, të negociojnë të gjitha kushtet e kontratës, duke përcaktuar lirisht përmbajtjen e saj, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe praktikave ndërkombëtare të së drejtës private.

3. Projektkontrata të mbështetet në projektin teknik, të hartuar nga korporata amerikane “Lockheed Martin Global Inc (LMGI)” dhe të miratuar nga komisioni i shqyrtimit të kërkesave të sistemeve dhe pajisjeve të modernizimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili funksionon pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Fondi për ndërtimin e këtij sistemi të jetë 2 314 697 000 (dy miliardë e treqind e katërmëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, i cili të ndahet në këste, i shtrirë në tri vite buxhetore dhe të paguhet me letërkredi ndaj kontraktorit. Në këtë fond përfshihen TVSH-ja dhe detyrimet doganore, të cilat do të shlyhen nga Ministria e Mbrojtjes pas lëvrimit të mallrave për ndërtimin e SIVHD-së. Ministria e Mbrojtjes të përballojë edhe të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera fiskale, që do të lindin gjatë procesit të ndërtimit të SIVHD-së, nga buxheti vjetor i miratuar për këtë Ministri.

5. Ministria e Mbrojtjes të parashikojë në kontratë kryerjen e punimeve ndihmëse (civile), të nevojshme për ndërtimin e SIVHD-së, të cilat të përballohen nga struktura e nga buxheti i kësaj Ministrie.

6. Ministria e Mbrojtjes, pas përfundimit të negociatave me LMGI-në, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave, për miratim, projektkontratën për ndërtimin e SIVHD-së.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha